



SQARIM PUBLIK PËR TË INTERESUARIT

Duke falënderuar redaksinë e emisionit "Fiks Fare" për kronikën e transmetuar me 13/2/2018 që prezanton shqetësimin për ndotjen e Liqenit të Fierzës, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) përfiton nga rasti të sqarojë pozicionin e saj, në kushtet kur listohen një sërë faktorësh dhe aktorësh që kanë shkaktuar ndotjen e tij, ndërsa përgjegjësia për pastrimin e Liqenit të Fierzës zhvendoset nga organet e tjera të ngarkuara me ligj në adresë të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, pa u njohur më parë me qëndrimin e KESH sh.a. lidhur me këtë çështje.

Misioni i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare është realizimi (prodhimi dhe tregtimi) i produkteve të energjisë elektrike nëpërmjet: i) shfrytëzimit me efektivitet të burimeve hidrike, ii) mirëmbajtjes cilësore të njësive prodhuese, iii) rritjes së sigurisë dhe jetëgjatësisë së veprave, dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, angazhimin për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe komunitetit që ndikohet prej veprimtarisë së saj.

Hidrocentralet në Kaskadën e Drinit janë ndërtaur për qëllimin primar ekonomik, atë të prodhimit të energjisë elektrike; në të njëjtën kohë sjell shumë përfitime të tjera për komunitetin dhe mjedisin, pasi mundëson kontrollin dhe menaxhimin e prurjeve natyrore të Lumit Drin dhe lumenjve që e ushqejnë atë, duke reduktuar shpeshhtësinë dhe riskun e përmbajtjeve të zonave në rrjedhën e poshtme të Lumit Drin.

Referuar VKM-së Nr. 122, datë 04.03.2004 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të KESH", shoqëria ka përgjegjësinë e administrimit dhe shfrytëzon vetëm tre hidrocentrale mbi kaskadën e lumit Drin (së bashku me tunelet e shkarkimit, sallat e makinave, magazina, etj.), pronar i të cilave është shteti Shqiptar. Në raport me burimet ujore (lumin Drin) KESH sh.a bën vetëm shfrytëzimin e tyre për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike duke mos pasur përgjegjësi administrimi për to.

Ndërkohë që administrimi i burimeve ujore rregullohet me anë të Ligjit Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i cili përcakton organet qëndrore dhe vendore që kanë përgjegjësinë për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore (nenet 5, 7 dhe 12 të ligjit).

Me keqardhje kontatojmë se në deklaratat e bëra në emision e transmetuar më datë 13.02.2018, nga përfaqësues të pushtetit Vendor, tregojnë mangësi të theksuar në lidhje me njohjen e detyrimeve dhe përgjegjësisë të vetë deklaruësit sa i përket administrimit të baseneve ujore dhe çështjeve mjedisore në këto basene. Sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", organet vendore për menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë: (i) këshillat e baseneve ujore dhe (ii) agjensitë e baseneve ujore.

Këshilli i basenit ujqor, me status juridik publik dhe varësi nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës në nivel vendor dhe ka për detyrë të:

- sigurojë ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujqor;
- sigurojë shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujqor, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
- sigurojë mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë/sasinë e tyre;
- identifikojë trupat ujqorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje;

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë parashikohen në Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Pikërisht, nën frymën e ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe të kuadrit ligjor që përcakton fushën e veprimtarisë së KESH, janë identifikuar dhe zbatohen përgjegjësitë korporative të shoqërisë të materializuara në Planin përkatës të Masave Social-Mjedisore.

Mbrojtja e mjedisit kërkon bashkëveprim dhe koordinim të përpjekjeve të autoriteteve publike dhe jo publike brenda fushës përkatëse të veprimit sikurse parashikohet në legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Rrjedhimisht, brenda fushës së përgjegjësisë së veprimtarisë së saj, KESH sh.a. është ofruar me kontributin e vet dhe do të vijojë të angazhohet në bashkëpunim me autoritete publike qëndrore dhe vendore për pastrimin e liqeneve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës dhe zonave përreth tyre.

Sa më sipër, i bëjmë thirrje të gjitha autoriteteve publike qëndrore dhe vendore, së bashku me njësitë përkatëse rajonale, të marrin masat për të ushtruar veprimtarinë e tyre sipas legjislacionit në fuqi dhe për koordinuar veprimet për një mjedis sa më të shëndetshëm për jetën e komunitetit dhe në përfitim të ekonomisë në zonat përgjatë basenit ujqor Drin – Bunë. KESH sh.a. do të vijojë të ofrojë kontributin e vet nën koordinimin e organeve përkatëse.